

AKT THEMELIMI
**I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "MIKE ne
Lagjen time"SH.P.K.**

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME
NENI 1

1.1. Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, sot me dt. 28.12.2022, me vullnet të lirë Ortaku i vetëm themelues:

- **Z. Enzo XINXO**, shtetas shqiptar, i biri i Pavli/t, i datëlindjes 07.04.1966, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, e identifikuar me nr. PersonalG60407138M;

si themelues i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosi të hartojë këtë akt themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

KREU II
EMRI, FORMA, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 2
EMRI

2.1. Emri i shoqërisë është "**MIKE ne Lagjen time"SH.P.K.**

NENI 3
FORMA

3.1. Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortaku do të përballojë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara për kapitalin.

NENI 4
SELIA

4.1. Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, në adresën: Rruga Bektash Berberi, Nr.32, Tiranë, Shqipëri.

- 4.2. Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 5

AFATI

- 5.1. Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

KREU III

O B J E K T I

NENI 6

- 6.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- i Shërbime konsulencë në fusha të ndryshme si atë ekonomike, të turizmit, shërbimit dhe mbrojtjes sociale, kulturore, etj;
- ii Aktivitet ndërmjetësimi për shoqëri të tjera të huaja dhe shqiptare në çfarëdolloj sfere të ekonomisë;
- iii Aktivitet si agjensi publicitare, marketing dhe reklama;
- iv Import-ekport dhe shitblerje me shumicë dhe me pakicë të mallrave industriale, ushqimore, blegtorale, bujqësore, lëndëve të para, pjesëve të këmbimit për makina të të gjitha tonazheve, medikamente mjekësore, pajisjeve elektrike, elektronike, hidrosanitare, hidraulike, duraluminut, pllakave të të gjitha llojeve, plastikës, gomës, bimëve mjekësore, lëndëve drusore dhe mobilieve, makina të të gjitha llojeve dhe tonazheve, të linjave të prodhimit dhe të përpunimit, konfeksioneve dhe të parfumerisë, por pa u kufizuar vetëm në këto;
- v Aktivitete nw fushn e formimit profesional, mjekesor, suportit psikologjik, farmaceutik, etj;
- vi Assistenca dhe sherbim mbeshtetese per pacientet e semure dhe te moshuar te jetojne per te mundesar nje jete autonome dhe kuptimplotë;
- vii Te bashkepunoje dhe /ose perfiton direkt apo indirekt pjesmarrje ne shoqeri, nderrmarrje, agjensi dhe sipermarrje te tjera te cilat mund te kene nje objekt aktiviteti te ndryshem.
- viii Aktiviteti tw tjera ne baze dhe nw mbwshtetje te misionit te saj social ne interes te komunitetit ku ajo vepron.
- ix Tregimi i pajisjeve dhe teknologjisë së sigurimit, aparaturave të posaçme të sigurimit, vendosja, mirëmbajtja dhe ruajtja e tyre gjatë përdorimit;
- x Aktivitet në fushën e ndërtimit të të gjitha llojeve, duke përfshirë këtu ndërtime për qëllime banimi, ndërtime me karakter social, sportiv, kulturor, tregtar, industrial, kanalizime, rehabilitime rrugësh, ndërtimin e tyre etj., por gjithnjë duke mos u kufizuar vetëm në to dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në këtë fushë;
- xi Kryerja e investimeve fusha të ndryshme të ekonomisë;

KAPITALI NENI 7

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në vlerën 100 ALL (njëqind lekë), e ndarë në 1 (një) kuotë.
- 7.2 Ortaku themelues i Shoqërisë zotëron kuotën në këtë shoqëri si më poshtë:
 - i. **Z. Eno XINXO**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë i barabartë me 1 kuotë me vlerë 100 (njëqind) lekë.
- 7.3 Kapitali themeltar është derdhur dhe shlyer tërësisht nga ortaku themelues. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

KREU IV ORGANET E SHOQËRISË

NENI 8

- 8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë :
 - i Asambleja e përgjithshme;
 - ii Administratori.
- 8.2 Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

ORGANI ADMINISTRATIV NENI 9

- 9.1 Administratore e parë e shoqërisë është zj. Daklea XINXO, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 032992930.

KREU V PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE

NENI 10

- 10.1 Ortaku themelues mund të vendosë me vullnetin e tij për të marrë pjesë në shoqëri të tjera, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

11.1 Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Legjislacioni i aplikuar

12.1 Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i shoqërisë dhe legjislacioni tregtar në fuqi.

NENI 13

Dispozita Përfundimtare

13.1 Akti i themelimit përpilohet në dy kopje origjinale me te njëjtën fuqi ligjore.

THEMELUES

Z. Eno XINXO

